



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ANTIKORRUPSIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE ANTIKORRUPSION
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MONITORIMIT STRATEGJIK NË FUSHËN
ANTI-KORRUPSION

Raport konsultimi i draft raportit të monitorimit janar-mars 2022, të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023

1. Titulli i draft aktit: Raporti i monitorimit për periudhën janar-mars 2022, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve - Konsultimi i parë (drafti 1) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, ka zgjatur 7 ditë pune (nga data 11 maj – 18 maj 2022). - Konsultimi në web të Ministrisë së Drejtësisë, ka qenë i hapur. Publikimi është bërë në datë 24.05.2022, në menu: prioritet/strategjia ndërsektoriale/strategjia kundër korrupsionit/raporte monitorimi në www.drejtësia.gov.al. - Konsultimi i dytë (drafti 2) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, është dërguar (i plotë) për rishikim dhe vlerësim kontributi në datë 24.05.2022. Ky konsultim ka përfunduar në datën 03.06.2022 dhe po finalizohet me zhvillimin e takimit të dedikuar të konsultimit në datë 10.06.2022.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë draft raport janë si vijon:

- Dërguar via email institucioneve përgjegjëse e zbatuese të PV SNKK dhe Departamentit në KM/ dërguar formati i raportimit për plotësim me shpjegimet dhe detajet e kërkuara. Dërguar formati i raportimit (për masat dhe aktivitetet).

- Komunikimi i drejtpërdrejtë via email për cdo kontribut/raportim të marrë; kthim për plotësim informacioni, të dhënash, informacion i munguar dhe komente të ardhura nga data 11.05.2022–18.05.2022.

- Faqja zyrtare e MD-së, www.drejtësia.gov.al

- Tryeza konsultimi e diskutimi teknike, të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

Takim i realizuar është: në datë 10.06.2022- tryezë ndërinstitucionale konsultimi, zhvilluar online (institucionet e Qasjes A – parandaluese, B – ndëshkuese, Qasjes C- ndërgjegjësuere).

Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit së të dhënave dhe përmbajtjes së draft raportit, u përcollën:

- nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike në stafin teknik të drejtorisë antikorrupsion artens.lazaj@drejtesia.gov.al,
- nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezën e konsultimit të zhvilluar në MD (online).

Gjithashtu Ministria e Drejtësisë/Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit shpalli për konsultim publik draft raportin e monitorimit janar-mars 2022, të Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023 edhe për OSHC-të, duke pritur komente, mendime dhe sugjerime nga ta brenda datës 3 qershor 2022, në adresën artens.lazaj@drejtesia.gov.al

4. Palët e interesit të përfshira

Draft raporti është konsultuar me përfaqësues të të gjithë institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e PV SNKK dhe të grupeve të interesit në fushën antikorrupsion.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Çështja e adresuar	Palët e interesuara	Vendimi (i pranuar/ i pranuar pjesërisht/ i refuzuar)	Justifikimi
Kërkohet shtim i të dhënave lidhur me masen A.9.3, duke pasqyruar procesin e ndjekur deri në miratimin e Planit të Integritetit, nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.	MEPJ	Jo i pranuar	Nuk është reflektuar plotësisht i informacionit të dërguar, pasi për shkak të miratimit të Planit të Integritetit nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, në muaj prill, ky element do të analizohet në raportin e monitorimit vijues, për periudhën janar – qershor 2022.
Kërkohet plotësim informacioni për buxhetet e përdorura në realizimin e masave dhe aktiteteve të Planit të Veprimit.	Mjekësia Ligjore ATP	I pranuar	Nuk ka patur informacion të shtuar lidhur me buxhetin, pasi nuk janë kryer shpenzime financiare shtesë në realizimin e produkteve.

<p>Kërkohej informacion i shtuar në lidhje me konkluzionin se ka ende nevojë të kemi rezultate më të dukshme në funksion të kapaciteteve inspektuese financiare, të cilat duhen të orientohen drejt çështjeve të mashtrimit dhe korrupsionit.</p>	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Ky konkluzion ka dalë nga nevoja për të theksuar rritjen e kapaciteteve të inspektimit financiar publik përmes zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit, si një kërkesë që buron nga masa A.7.3 e Planit të Veprimit 2020 – 2023 të SNKK.</p>
<p>Kërkohej të ndryshohet formulimi i pikës 7 të arritjeve kryesore: “Sipas të dhënave statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme, në prokuroritë e juridiksionit të Përgjithshëm janë regjistruar 48 procedime penale për veprat penale në fushën e korrupsionit. Janë dërguar për gjykim 28 procedime me 30 të pandehur, nga të cilët janë dënuar nga gjykata 11 të pandehur”.</p> <p>Kërkohej plotësimi i raportimit për aktivitetin B.1.4.1 sipas informacionit shtesë të përcjellë.</p>	<p>Prokuroria e Përgjithshme</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Informacionet e dërguara janë pranuar dhe janë shtuar në raport.</p>
<p>Kërkohej plotësimi i informacionit dhe rikategorizimi i statusit të zbatimit të aktivitetit A.4.5.2 si “e zbatuar”, pasi Në funksion të stafit të përfshirë në grupet për monitorimin e rasteve të</p>	<p>Policia e Shtetit</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport</p>

denoncuarra për prirje për korrupsion, sektori për Korrupsionin në DPPSH ka caktuar 13 oficerë nga të cilët 1 në qendër dhe 12 ne qarqe.			
Kërkohet plotësimi i raportimit për aktivitetet dhe masat e SPAK, për objektivet B1 e B2	SPAK	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport